



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.469/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Afijete Sada Glllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e evidentuar si Anr.469/2021, të datës 14.02.2021, e paraqitur nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i Shqiptohet gjobë, në lartësi prej 500 (pesëqind euro), dhe detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënimin e dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Me datë 14.02.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.469/2021, nga subjekti politik LVV, e paraqitur kundër subjektit politik PDK, në të cilën pretendon se në ditën e heshtjes zgjedhore më datë 13.02.2021 në rrjetin social facebook sekretari I Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Trim Sylja ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë një postim një foto, me të cilën bënë thirrje për të votuar numrin e subjektit politik PDK-së. Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuara në cilësi të provave materiale.

Në përgjigjet në ankesë subjekti politik PDK thekson se ankesa Anr. 469/2021 është përsëritje e Ankesës Anr. 454/2021, për të cilën kanë dhënë përgjigje.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale – fotografive të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës shihet se në rrjetin social facebook sekretari I Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Trim Sylja ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë një postim një foto, me të cilën bënë thirrje për të votuar numrin e subjektit politik PDK-së, veprim ky i cili është në

kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b, të LZP-së, me të cilin ka bërë promovimin e subjektit politik PDK, ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Andaj PZAP, duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se PDK, është përgjegjëse për veprimet e tyre, pasi që me veprimet e lartcekura ka shkelur nenin 36, paragrafi 1, pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se kemi të bëjmë me shkeljen nga mbështetesi
- Faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba PDK ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme,
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet që bien ndesh me rregullativën ligjore, që te mos cenohet heshtja zgjedhore duke siguruar klimë të qetë dhe të përshtatshme për votim të lirë si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.”, ashtu siç është vendosur si në të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.469/2021 më datë 16.02.2021



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së